



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit

Nr. 649 Prot.

Tiranë më 4 .10.2017

Lënda: Marrje mendimi mbi vendimin nr.152, datë 28.09.2017 të Bordit të ERE.

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

AUTORITETIT TË KONKURENCËS

OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES TË ENERGJISË ELEKTRIKE

KESH SH.A

OST SH.A

SHOQATA AAES

SHOQATA AREA

SHOQATA E PRODHUESVE TË VEGJËL TË ENERGJISË ELEKTRIKE

SHOQATA FIAA

SHOQATA ACERC

TIRANË

Të nderuar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë vendimin e Bordit të ERE, nr. 152, datë 28.09.2017, për "Fillimin e procedurës për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike". Për sa më sipër, para se ERE të vijojë me miratimin e "Licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike", lutemi të shprehni opinionet dhe komentet tuaja mbi këtë draft brenda 15 ditëve nga marrja dijani.

Kopje të këtij drafti, do të gjeni në faqen e internetit të ERE-s, në adresën www.ere.gov.al

Me respekt,

KRYETARI
Petrit AHMETI



Adresa: Bulevardi "Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu 1023 , Tiranë; Tel +355 42 69-590; www.ere.gov.al; E-mail realb@ere.gov.al .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr.152, Datë 28.09.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E OPERIMIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e “draft– licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se,

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 37 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ERE lëshon licencë për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike.
- Neni 37 pika 3 parashikon që ERE vendos kushtet e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e licencës për veprimtarinë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI

